



KOMUNIKATË PËR SHTYP

Takimi i Dytë i Forumit për Trashëgiminë Kulturore, i përqendruar në Qendrën Historike të Prizrenit

Prishtinë, më 5 mars 2009

Në Muzeun e Kosovës, sot është mbajtur takimi i dytë i Forumit për Shkëmbim të Informatave Teknike rreth Trashëgimisë Kulturore. Forumi është një nismë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) dhe me zyrën e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (EUSR).

Forumit ka për qëllim t'i bashkojë në një tryezë hisedarët në fushën e trashëgimisë kulturore për të lehtësuar shkëmbimin e informatave. Ai do të përkrah autoritetet kosovare të tejkalojnë sfidat e tyre të perspektives evropiane, duke rritur kështu qëndrueshmërinë afat-gjate të të gjitha objekteve të Trashëgimisë Kulturore në Kosovë.

Diskutimet gjatë takimit të dytë të Forumit u përqendruan në ruajtjen dhe zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit, me ç'rast theksuan potencialin e tij si njëri prej qyteteve më të pasur dhe me diversitetin më të madh kulturor në Kosovë. Forumi preku projektet për Prizrenin, si ato ekzistuese ashtu edhe ato të planifikuara, vizionin e komunës për të ardhmen e qendrës historike si dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme kur është fjala për Trashëgiminë Kulturore në Kosovë – sidomos të Institutit Lokal për Mbrojtjen e Monumenteve.

Takimi i ardhshëm i Forumit do të mbahet në mes të muajit prill.

Klikoni [këtu](#) për të lexuar kumtesën për shtyp me informacionin përkatës nga takimi i parë i Forumit, i cili është mbajtur në Prishtinë më 28 janar 2009

Për informata të tjera, kontaktoni Maja Pavlovic në telefonin 038 5131 253, maja.pavlovic@ec.europa.eu, ose Fjolla Çekun në telefonin 038 5131 327, 044 508 211, fjolla.ceku@ec.europa.eu,

www.delprn.ec.europa.eu

[Klikoni këtu](#) për tu abonuar në buletin e ZNKE-së